



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 03/2009
Më 03.02.2009, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Fatmir Rexhepi, Sala Berisha – Shala, Berim Ramosaj, Kaqusha Jashari, Zef Morina dhe Mufëra Şinik.

Mungoi: Slobodan Petroviq.

Pjesëmarrës të tjerë: Lutfi Zharku, ministër i MTI-së, Fatos Sahiti, këshilltar ligjor i ministrit, Sytrime Dervisholli, zyrtare e CEFTA-s, Ruzhdi Shehu, zyrtar i MTI-së, Haxhi Gashi -USAID, Blerina Uka - NDI, Kaltrina Ademi - KDI, Besim Zeqiri dhe Sagita Muço - ICO, Lejla Selimi - OSBE.

Nga Zyra Mbështetëse: Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 27. 01. 2009;
3. Raportimi i MTI-së lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së CEFTA-s dhe të Ligjit nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe me derivate të naftës në Kosovë;
4. Shqyrtimi i Ligjit për shpronësim;
5. Të ndryshme.

I. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja i propozoi Komisionit të hiqet nga rendi i ditës pika e katërt, sepse është njoftuar nga USAID-i se Banka Botërore, Ministria e Transportit dhe e Post-telekomunikacionit kanë amendamente/propozime për këtë ligj, kështu që nuk ka kushte të shqyrtohet ky ligj, derisa të përgatitet drafti përfundimtar.

Komisioni u pajtua më propozimin e kryetares dhe e miratoi rendin e ditës.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 27. 01. 2009

Procesverbali i mbledhjes së 27 janarit 2009 u miratua pa vërejtje.

III. Raportimi i MTI-së lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së CEFTA-s dhe të Ligjit nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe me derivate të naftës në Kosovë

Kryetarja – E falënderoi ministrin Zharku që iu përgjigj ftesës. Kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të ndahet në dy nënpika, si: a) Raportimi i ministrit Zharku, lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së CEFTA-s, dhe b) Ligji nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe me derivate të naftës në Kosovë.

a) Raportimi i ministrit Zharku lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së CEFTA-s

Lutfi Zharku - ministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë – MTI – Falënderoi për pritjen dhe ua dorëzoi deputetëve një kopje të Marrëveshjes së CEFTA-s që e elaboron pozitën e Republikës së Kosovës për të drejtat dhe detyrimet që dalin nga kjo marrëveshje. Tha se një ndër aktivitetet e MTI-së me rëndësi ishte edhe angazhimi aktiv për zbatimin e Marrëveshjes për tregti të lirë me vendet e rajonit, e njohur si Marrëveshja CEFTA-s 2006, që ka filluar të zbatohet në shtator të vitit 2007. Ministri shtoi se Kosova ka konsistuar për krijimin e strukturave të menaxhimit të Marrëveshjes, siç është emërimi i pikës së kontaktit për Kosovën dhe i përfaqësuesve të tri nënkomiteteve të CEFTA-s. Pikë kontakti është caktuar këshilltari, z. Fatos Sahiti, përfaqësues në Nënkomitetin për Dogana, për Origjinë të Mallit, z. Sali Hoda, në Nënkomitetin për Bujqësi, z. Frymëzim Isufaj, ndërkaq në Nënkomitetin për Barriera Tarifore dhe Jotarifore, z. Ibush Luzha. Po ashtu, është emëruar përfaqësuesi ynë në Komitetin Drejtues të Sekretariatit të CEFTA-s, znjsh. Sytrime Dervisholli. Ministri i paraqiti aktivitetet e vendit në CEFTA: në vitin 2008 janë zhvilluar takimet: më 26 qershor 2008 në Podgoricë, në Nënkomitetin për Dogana, së bashku me përfaqësues të UNMIK-ut; më 5 shtator 2008, në projektin e CEFTA-s “Përmirësimi i mundësive për tregti” në Tiranë, në të cilin përfaqësuesit e Serbisë e lëshuan mbledhjen për shkak të mospjesëmarrjes së përfaqësuesit të UNMIK-ut; më 11 nëntor 2008 mbledhja e përfaqësuesve të shteteve të CEFTA-s në Bruksel ose e pikave të kontaktit. Edhe në këtë mbledhje përfaqësuesit e Serbisë e lëshuan mbledhjen. Më 27 - 28 janar 2009 Nënkomiteti për Bujqësi në Bruksel, ku u zhvilluan bisedime bilaterale më Kroacinë, Maqedoninë dhe Shqipërinë për liberalizimin e mëtejme të tregtisë për prodhime bujqësore. Vlen të theksohet se Kosova edhe këtu është përfaqësuar në nivel qeveritar pa përfaqësues të UNMIK-ut. Ndërkaq në mbledhjen e 7 - 8 tetorit

2008, në nivel ekspertësh në Moldavi, në të cilin përfaqësuesit tanë nuk morën pjesë për shkak se ftesa nuk i ishte dërguar drejtpërsëdrejti MTI-së, por nëpërmjet UNMIK-ut, që e ka përcjellë vetëm një ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Po ashtu e njoftoi Komisionin se Kosova është kryesuese e Nënkomitetit për Barriera Tarifore dhe Jotarifore. Mbledhja e parë parashihet të mbahet në maj të këtij viti në Prishtinë. Ministri Zharku i njoftoi deputetët edhe për pengesat që po dalin në zbatimin e kësaj marrëveshjeje, sepse siç dihet që nga fillimi i dhjetorit Marrëveshja po shkelet në mënyrë flagrante nga ana e Serbisë, që i nuk e lejon eksportin as kalimin e mallrave tona në tregun e tyre. Marrëveshja po ashtu po shkelet edhe nga ana e Bosnje dhe Hercegovinës, që mallrat tona po i ngarkon me tarifa të plota doganore. MTI-ja, menjëherë pas njoftimit për këto shkelje e njoftoi Sekretariatit e CEFTA-s, që ka kthyer përgjigje se të gjitha palët janë njoftuar, por kjo është çështje politike dhe nuk mund të zgjidhet në këtë nivel. Edhe pse në dhjetor 2008 janë zhvilluar kontakte intensive në kuadër të Nënkomitetit për Dogana për zgjidhjen e kësaj çështjeje, nuk pati sukses. Tha se tanimë janë shterur të gjitha mundësitë e zgjidhjes së kësaj çështjeje në nivel të Nënkomitetit për Dogana. Më 9 janar 2009 i kemi dërguar shkresë zyrtare ministrit për zhvillim ekonomik të Malit të Zi, kryesues i radhës për Marrëveshjen, që ta thërrasë mbledhjen e Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s për konsultime të menjëhershme. Më 26 janar 2009, e morëm shkresën e ministrit malazez, me të cilën na njoftonte se pavarësisht se Mali i Zi e ka pranuar Republikën e Kosovës, mbledhja duhet të thirret nga ana e UNMIK-ut, pasi që ai është nënshkruar i Marrëveshjes. Njoftoi se më 28 janar 2009 delegacioni i Qeverisë së Kosovës, i kryesuar nga zv.kryeministri Kuçi, ministri Ahmet Shala dhe vetë ministri Zharku, janë zhvilluar takime me zyrtarë të lartë të Komisionit Europian. Në fund premtoi se takimet për këtë çështje pritet të vazhdojnë. Pas tyre besohet se do të merren hapat e nevojshëm për zbllokimin e eksportit të mallrave të vendit tonë.

Kryetarja – E pyeti ministrin, sa mund t’u ndihmojë bizneseve kosovare Marrëveshja e CEFTA-s, dhe për përfitimet që mund t’i këtë biznesi në këtë drejtim.

Fatmir Rexhepi – Shfaq pakënaqësinë lidhur me qëndrimet e MEF-it, dhe të MTI-së për zbatimin e CEFTA-s, për shkak të pasivitetit. E pyeti ministrin Zharku, se cila është strategjia dhe cilat janë vendimet e MTI-së dhe të Qeverisë për këtë çështje. Në fund kërkoi nga ministri që t’i caktojë kushtet dhe të reagojë ndaj Serbisë me masa të përkohshme përkatëse dhe çdo zbatim i marrëveshjeve të behet në bazë të partneritetit.

Safete Hadergjonaj – Pas vlerësimit pozitiv të performancës së Qeverisë dhe të pjesëmarrjes së vendit tonë në CEFTA, kërkoi nga Ministri të shtrihet ndikimi i Republikës së Kosovës në marrëveshjet e nënshkruara nga UNMIK-u. Pyeti se çfarë është bere deri me tani në këtë drejtim dhe çfarë do të bëjë Qeveria në të ardhmen që marrëveshjet që janë nënshkruar nga UNMIK të njihen si të nënshkruara nga Republika e Kosovës.

Kaqusha Jashari – U pajtua me deputeten Hadergjonaj. Po ashtu kërkoi nga MTI-ja që sa më parë t’i kryejë procedurat që vendi ynë në marrëveshjet rajonale dhe ndërkombëtare të përfaqësohet nga MTI-ja, gjegjësisht nga Qeveria, d.m.th. të evitohet

pjesëmarrja e UNMIK-ut, sepse nuk do të ishim palë e barabartë në qoftë se do të vazhdohej një gjendje e tillë e përfaqësimit të UNMIK-ut.

Ethem Çeku – Në fillim të diskutimit ua kujtoi të pranishëmve, se vendi ynë e ka nënshkruar edhe Traktatin e Athinës. Kërkoj nga ministri të njoftohet se a ka Qeveria plan për reciprocitet dhe cilat janë politikat e saj për këtë çështje. Po ashtu kërkoj reciprocitet edhe kur bilanci tregtar është negativ.

Haki Shatri – Theksoi se edhe CEFTA është në njëfarë krize, sepse nuk i detyron vendet nënshkruese të saj, kështu që Kosova, nëse reagon keq, nuk mund t'ia imponojë sjelljet Serbisë. Gjithashtu bëri thirrje për maturi në lidhje me këtë çështje, në mënyrë që masat që do të merren të mos jenë hakmarrje e verbët ndaj Serbisë, por të jenë në dobi të interesave të vendit tonë.

Zef Morina – Theksoi se nuk do të ishte e logjikshme në qoftë se marrëveshjet e nënshkruara nga UNMIK-u, të mos vlejnin edhe për Republikën e Kosovës, dhe se sjelljet e UNMIK-ut, janë joserioze dhe jo të sinqerta. Në fund kërkoj të respektohet reciprociteti ndaj Serbisë dhe të gjitha marrëveshjet e nënshkruara nga UNMIK-u të jenë marrëveshje edhe për shtetin tonë.

Berim Ramosaj – Tha se CEFTA si akt i rëndësishëm dhe spektakular në kohën e nënshkrimit të saj është vlerësuar, qoftë si raport rajonal, qoftë si akt politik strategjik për vendin, ndërsa tani problemi qëndron në atë se shtetet nënshkruese të saj nuk e zbatojnë këtë marrëveshje. Ndërkaq nga ministri dhe nga Qeveria kërkoj që kur të jetë fjala për çështjen e biznesit dhe të tregut në përgjithësi, të kihet kujdes, të ndryshohet qasja dhe të vepruhet si subjekt shtetëror. Të gjitha raportet të jenë në këtë frymë dhe të mos arsyetohemi kinse marrëveshjet i ka nënshkruar UNMIK-u.

Lutfi Zharku – Duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, tha se tanimë UNMIK-u nuk është e nevojshme të marrë pjesë në takimet e Qeverisë për këtë marrëveshje. Ndërkaq secila marrëveshje e nënshkruar nga UNMIK-u respektohet edhe nga Republika e Kosovës. Po ashtu tha se me shtetet që e kanë pranuar pavarësinë nuk kemi probleme të tilla si me Serbinë. E kemi përkrahjen e plotë të biznesit dhe kemi bashkëpunim më të gjitha bizneset e vendit. Më tej ministri shtoi se Qeveria së shpejti do t'i zbatojë masat e veta në interes të ekonomisë së vendit. Në fund tha se Qeveria ka plan strategjik për ta përballuar këtë situatë me masa të reciprocitetit, si me aplikimin doganor prej 10% për çdo mall që hyn nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, si dhe me masën e dytë, ndalesën e importit nga këto vende. Po ashtu tha se kemi të drejtë të zbatojmë masa të tilla ndaj këtyre vendeve në bazë të dispozitave të Marrëveshjes së CEFTA-s, sepse jemi palë e dëmtuar. Shtoi se eksporti në masë të madhe ka rënë për shkak të shkeljes së Marrëveshjes, kurse importi nga Serbia ka rënë nga 220 në 148 milionë euro në vit. Mirëpo bilanci tregtar është i disfavorshem për vendin tonë.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

- I. Të formohet Grupi i punës për hartimin e një rekomandimi drejtuar Qeverisë për zbatimin e Marrëveshjes së CEFTA-s,
- II. Grupi i punës e ka këtë përbërje: Berim Ramosaj, Myzejene Selmani, Ethem Çeku dhe Haki Shatri.

b) Zbatimi i Ligjit nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe me derivate të naftës në Kosovë

Lutfi Zharku – Tha se në tërësi është në zbatim Ligji nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe me derivate të naftës. Në pajtim edhe me dispozitat e Ligjit nr. 02/L-20 për kërkesat teknike të produkteve dhe për vlerësimin e konformitetit, MTI-ja ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ nr. 2008/21, me të cilin përcaktohen vlerat kufizuese të sqfurit, plumbit, olefineve, aromateve, benzenit, oksigjenit, ujit, hidrokarbureve aromatike, që mund të vihen në qarkullim në tregun e Kosovës dhe për mënyrën e vlerësimit të konformitetit.

Berim Ramosaj – Duke e marrë parasysh këtë udhëzim administrativ e pyeti ministrin: Cili është ndryshimi në pjesëmarrje të sqfurit në derivate, cilët janë fituesit e laboratorëve, kush është pronar i KOSOVA-LAB-it, çka e ka shtyrë MTI-në, ta rritë përqindjen e sqfurit dhe çfarë masash ka marrë MTI-ja për kontingjentet që kanë hyrë dhe hyjnë çdo ditë me vaj dysulfurik?

Haki Shatri – Për njoftimet e biznesit kishte vërejtje për ekzemplantet e cisternave me naftë. Secila cisternë duhet të këtë ekzemplant, kurse prejardhja e secilës cisternë është e njëjtë.

Safete Hadergjonaj – Edhe pse tha se është detyrë e Institutit të Metrologjisë për matjet në pompa të benzinës, kërkoi nga ministri të dijë çfarë masash merr MTI-ja për këtë çështje.

Ethem Çeku – Pyeti sa duhet të jetë sipas Ligjit përqindja e rezervës së karburantit që duhet ta këtë kompania në dispozicion?

Lutfi Zharku – Duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve theksoi se MTI-ja nuk është kompetente për hyrjen e vajit dysulfurik. Nuk ka ndryshuar përqindja e sqfurit në naftë, përpos në mazut, nga 1% në 2% dhe në vajrat lubrifikuese, në 3.5%. Këtë ngritje e ka kushtëzuar importi. Ligji ia mundëson MTI-së të zgjedhë dhe ta autorizojë Laboratorin për Derivate. Kjo bëhet në bazë të besueshmërisë që e fiton kompania. Ligji e përcakton se kompania që operon në vend duhet t'i këtë 5% të derivateve rezervë. Sa u përket ekzemplantëve të cisternave, ministri theksoi se kjo bëhet për arsye sigurie, sepse duhet të merret secila mostër për verifikim. Duke aluduar në rastin e cisternave me vaj dysulfurik, me anë të kontrollimit të kalibrimit të pompave të derivateve dhe me anë të Komisionit për inspektim dhe të Institutit të Meteorologjisë behet matja e derivateve. Theksoi se nuk

është në dijeni për pronarin e laboratorit KOSOVA-LAB. Për këtë çështje premtoi se Komisionit do t'ia sjellë listën e të gjitha bizneseve të regjistruara në MTI. Atëherë do të gjendej një njoftim jo vetëm për këtë kompani, por për të gjitha kompanitë e vendit.

IV. Të ndryshme

IV. a) Projektligji për masat antidamping

Kryetarja – Kërkoi nga eksperti i USAID-it njoftim për këtë projektligj.

Haxhi Gashi – Theksoi se pas konsultimeve me ekspertët e USAID-it, për shkak të vëllimit të madh të punëve, nuk mund ta procedojmë ekspertizën për këtë çështje. Kërkoi kohë më të përshtatshme për shqyrtimin e këtij projektligji.

IV.b) Strategjia legislative e Qeverisë për vitin 2009

Kryetarja – I njoftoi anëtarët e Komisionit për arritjen e Strategjisë legislative të Qeverisë për vitin 2009. Njëherësh kërkoi të formohej një grup i punës për këtë çështje.

Pas debatit të gjerë Komisioni e nxori këtë

Përfundim

- I. Formohet grupi i punës për hartimin e Planit legjislativ për vitin 2009 me këtë përbërje: Sala Berisha – Shala, kryesuese, Myzejene Selmani, Berim Ramosaj, Múfera Şinik dhe Ethem Çeku.

IV. c) Çështjet vijuese

Kryetarja – Kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen se për cilin projektligj janë të interesuar të bëjnë dëgjim publik.

Safete Hadergjonaj - Do ishte mirë që për të gjitha ato ligje që janë me interes për publikun të bëhen dëgjime publike. Hadergjonaj e tha nga përvoja se dëgjimet publike janë të mirëseardhura sepse rekomandimet e dhëna nga ekspertet dhe grupet e interesit ndihmojnë shume në amendamentim.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni nxori këtë

Përfundim

- I. Të organizohet dëgjimi publik në fazën e shqyrtimit të Projektligjit për zonat ekonomike.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

Kryetare e Komisionit

Myzejene Selmani